



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:144884

Datë: 30.03.2023

Numri i dokumentit: 04140147

E.nr.985/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve: A.M., D.N.-A. dhe I.S., të cilët i përfaqëson av Abdurrahim Islami nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 30.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.985/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.985/22, të datës 29.07.2022, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:144885, të datës 22.02.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 13.01.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 3,157.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.985/22, më datë 30.03.2023

GJYQTARI
Faton Ajvazi